



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Analizë Politike 2010/6

Shkaqet dhe shkaset e krizës institucionale në Kosovë



Prishtinë, nëntor 2010

Përgatitur nga: Krenar Gashi

Me kontributin e Ariana Qosaj-Mustafajt

Copyright © 2010 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: info@kipred.net apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rexhep Mala, 5A, Kati II

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefon dhe Fax: +381 38 227 778

www.kipred.net

1. Hyrje:

Pas shpalljes së mendimit këshillëdhënës nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) mbi ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së njëanshme të Kosovës në përputhshmëri me normat e së drejtës ndërkombëtare, vendi hyri në fazën e fundit dhe më të rëndësishme të procesit të shtet-ndërtimit. Mendimi pozitiv i GJND-së¹ për Kosovën shtyu që me 10 shtator 2010, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së të miratoi një rezolutë e cila thërret për një dialog mes Prishtinës dhe Beogradit.² Përkundër faktit që ky dialog perceptohet ndryshe nga ana e dy palëve, në praktikë ekziston një pajtim i heshtur se bisedat do të fillojnë, pikë së pari në temat me interes të përbashkët dhe me natyrë sa më pak politike, siç është çështja e personave të pagjetur. Përbrenda Kosovës, pos përgatitjeve për dialog me Beogradin, autoritetet vazhdonin me marrjen e vendimeve qenësore për vendin sikurse privatizimin e ndërmarrjes publike më fitimprurëse në vend – Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) – fuqizimin e reformës zgjedhore, miratimin e ligjit për regjistrimin e popullsisë si dhe buxhetin e Kosovës për vitin 2011. Megjithatë, një sërë ndodhish politike e institucionale, shumica prej të cilave ishin të paplanifikuara por jo edhe të paparashikueshme, ndaluan këto procese duke e zhytur vendin në një krizë qeveritare e politike.

Ani pse Kosova kishte vendosur që të mbajë zgjedhje të parakohshme me datën 13 shkurt të vitit 2011³, ajo që pasoi skenën politike të Kosovës e çoi vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme, tanimë të caktuara për 12 dhjetor 2010. Me këto veprime të ngutshme, demokracia e re e Kosovës vazhdon të mbetet në test. Procesi i zgjedhjeve mbeti peng i këtyre zhvillimeve, meqë edhe vet organi kryesor për organizimin e tyre, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ka deklaruar se nuk garanton cilësi të procesit të zgjedhjeve të caktuara për datën 12 dhjetor 2010.⁴

Në këtë analizë të shkurtër, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) e bën rishikimin e gjendjes së krijuar dhe pasojave eventuale, duke marrë parasysh të gjitha zhvillimet e fundit politike dhe institucionale në Kosovë që kanë çuar në shkarkimin e Qeverisë dhe shpërbërjen e Kuvendit të Kosovës. KIPRED, në këtë punim, shpalos dallimet mes shkaseve dhe shkaqeve të vërteta që çuan deri tek kjo krizë institucionale.

¹ Mendimi Këshillëdhënës, *Përputhja me ligjet ndërkombëtare e shpalljes së njëanshme të Pavarësisë së Kosovës*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, 22 korrik 2010

² “Sekretari i Përgjithshëm e mirëpret Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme rreth Pavarësisë së Kosovës”, Sekretari i Përgjithshëm, Kombet e Bashkuara, 13 shtator 2010, <http://www.un.org/News/Press/docs/2010/sgsm13093.doc.htm>

³ “Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen më 13 shkurt 2011”, Zyra e Presidentit të Kosovës, 15 tetor 2010, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1401>

⁴ Deklaratë e Kryetares së KQZ-së, Valdete Daka, e raportuar në të përditshmet Koha Ditore, Zëri dhe Express të dates 18 tetor 2010

2. Respektimi i Kushtetutës

Menjëherë pas miratimit të rezolutës për Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, me 24 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës njoftoi se kishte marrë vendim në lidhje me ankesën e parashtruar nga 32 deputetë të Kuvendit të Kosovës, për kushtetutshmërinë e mbajtjes së pozicioneve të dyfishta nga ana e Presidentit Fatmir Sejdiu, i cili njëherësh ishte edhe kryetar i partisë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese, thuhej se Presidenti i Republikës kishte bërë shkelje të rëndë të kushtetutës për faktin se kishte mbajtur post politik, gjegjësisht postin e të parit të LDK-së.⁵ Si pasojë, me 27 shtator 2010, Presidenti Fatmir Sejdiu dha dorëheqje të parevokueshme nga posti i presidentit të shtetit, duke i dhënë kështu prioritet pozitës së të parit të LDK-së ndaj asaj të shtetit.⁶ Në pajtim me kushtetutën, ushtrimin e detyrave të Presidentit të shtetit i morri përsipër Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ishte kurrfarë befasi, meqë Kushtetuta e Kosovës në mënyrë eksplicite përkufizon se Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.⁷ Rrjedhimisht, deklaratat mediale dhe interpretimet e ndryshme politike që pasuan mbi dorëheqjen e presidentit dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese si shkaqe për nisjen e krizës qeveritare dhe institucionale në Kosovë nuk qëndrojnë. Këto deklarata, të lansuara nga dy ish-partnerët e koalicionit qeverisës PDK-LDK, mund të shihen vetëm si gjeeste politike për të përfituar poena politike tek elektorati dhe nisjen e fushatës paraelektorale në Kosovë. Kësisoj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe dorëheqja e Presidentit Sejdiu ishin vetëm shkaqe të krizës institucionale, e jo shkaktare të saj.

Një prej shkaqeve të vërteta të krizës i ka filllet shumë më herët, qysh me krijimin e koalicionit qeverisës. Pasojat të cilat po ndihen tani në fund të kësaj qeverisjeje, e kanë bazën te fakti se dy partitë e koalicionit qeverisës PDK-LDK kanë qeverisur në bazë të një marrëveshjeje që ishte ndesh me kushtetutshmërinë në Kosovë. Fillimisht kjo marrëveshje shkelte Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë⁸ e më pas, pas 15 qershorit 2008, edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës,⁹ meqë të dyja përkufizonin se Kryetari i Kosovës, respektivisht Presidenti, nuk mund të ushtrojë funksione tjera politike.

Sipas marrëveshjes së koalicionit qeverisës, të arritur me 7 janar 2008, PDK-ja ka mbajtur postin e kryeministrit, një zëvendëskryeministër dhe shtatë (7) ministra. LDK-ja, në anën

⁵ Njoftim për media i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, <http://gjk-ks.org/?cid=1,28,193>

⁶ Deklaratë e Presidentit të Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, 27 shtator 2010, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,1360>

⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 88, pika 2

⁸ Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Neni 9.2.7

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 88, pika 2

tjetër, mbajti postin e Presidentit, një zëvendëskryeministër dhe 5 ministra.¹⁰ Se posti i Presidentit ishte pjesë e marrëveshjes dëshmon fakti që Fatmir Sejdiu, në të njëjtën seancë parlamentare kur u miratua kabineti qeverisës dha dorëheqje për t'u zgjedhur për një mandat të dytë, pesëvjeçar, me votat e deputetëve të LDK-së dhe PDK-së. Edhe atëherë, Sejdiu pati mbajtur postin e të parit të LDK-së, përmes ndihmës së akterëve kyç të bashkësisë ndërkombëtare, duke shpikur formulën e “ngrirjes” së këtij posti.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me 15 qershor 2008, është intensifikuar debati publik rreth kushtetutshmërisë së posteve të dyfishta të Presidentit. Megjithatë, ky debat kaloi në heshtje si pasojë e një konsensusi mes partive në pushtet dhe bashkësisë ndërkombëtare, duke vazhduar kështu me “traditën” e krijuar të qeverisjes në Kosovë sikur në kohën e UNMIK-ut, kur marrëveshjet mes spektrit politik dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ishin përmbi çdo normë praktike e ligjore.

Se partitë e koalicionit ishin të vetëdijshme që marrëveshja ishte ndesh me kushtetutën, e vërtetoi me 18 tetor 2010 edhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, nënkryetar i PDK-së, i cili tregoi publikisht se partia e tij dhe ai personalisht janë munduar që të ndalojnë procesin e parashtrimit të kërkesës së 32 deputetëve në Gjykatën Kushtetuese.¹¹ Ndërhyrjet e këtilla në punët e institucioneve, pavarësia e të cilave garantohet me kushtetutë, dhe krijimi i praktikave se marrëveshjet mes partive politike, përderisa ato nuk e pengojnë faktorin ndërkombëtar, janë përmbi aktin më të lartë ligjor në vend, janë shkaqet kryesore të brishtësisë së demokracisë në Kosovë dhe me këtë edhe shkaqe të krizës së shkaktuar institucionale.

3. Mes shkaqeve dhe shkaseve

A) Privatizimi i PTK-së

Pas dorëheqjes së Fatmir Sejdiut nga posti i Presidentit të shtetit, është vërejtur një sjellje ndryshe e LDK-së brenda koalicionit qeverisës. Megjithatë, të dy partitë e koalicionit ishin përkrahëse të politikave dhe prioritetëve të hartuara prej tyre, e sidomos për politikën që për financimin e projektit madhor të ndërtimit të autostradës Morinë-Merdare, mjetet shtesë të nevojitura do të vinin prej privatizimit të PTK-së.

Privatizimi i PTK-së kaloi suazat e agjendës vendore, duke u bërë temë që u përmend edhe nga Sekretarja Amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, gjatë vizitës së saj në Kosovë, me 13 tetor 2010. Madje, sipas deklaratave të tyre të mëvonshme nëpër media, të dy partitë e koalicionit qeverisës i premtuan znj. Clinton se Kuvendi i Kosovës do ta miratonte strategjinë e qeverisë për privatizim të PTK-së qysh në seancën e radhës.

¹⁰ Numri i ministrave është rritur në ndërkohë me shtimin e ministrive të reja.

¹¹ Deklaratë e Hajredin Kuçit në emisionin “Zona e Debatit” në TV Klan Kosova, 18 tetor 2010

Në seancën e Kuvendit të Kosovës të datës 14 tetor 2010, LDK-ja kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës miratimi i strategjisë së qeverisë për privatizimin e PTK-së. Meqë kërkesa e LDK-së nuk kaloi, Kryetari i Kuvendit, nën presion dhe ndikim të vazhdueshëm të Kryeministrit, e vuri shpejt në votim këtë strategji. Për më shumë presioni direkt i të parit të ekzekutivit në punën e legjislativit, tregoi edhe njëherë brishtësinë e qeverisjes demokratike që ekzistonte në Kosovë.

Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, bëri edhe shkelje të rregullores së punës, meqë e deklaroi si të miratuar strategjinë, me 47 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, pa pasur kuorum të mjaftueshëm për të votuar, meqë deputetët e LDK-së në fakt kishin filluar ta lëshonin seancën dhe kishin tërhequr kartelat e tyre gjatë votimit elektronik. Përkundër faktit që këtë lëshim zoti Krasniqi e përmirësoi shumë shpejt me anulimin e votimit të nesërmen, nxitimi i PDK-së për të miratuar në shpejtësi strategjinë për privatizim të PTK-së la vend për interpretime të shumta.

Si rrjedhojë e kësaj situatë në Kuvend, LDK e gjeti shkasin për të u larguar nga koalicioni qeverisës duke përmendur edhe lënien anash apo injorimin që i ishte bërë këtij subjekti nga partneri i koalicionit, PDK-ja, në projektet madhore të Kosovës. Ky veprim i LDK-së është edhe një përgjigje e vonshme e aferës së Zanzi-Barit të nëntorit 2009, kur PDK-ja kishte deklaruar se do ta përjashtonte LDK-në nga koalicioni dhe do të qeveriste vendin me Aleancën Kosova e Re (AKR) të Behxhet Pacollit dhe Lidhjen Demokratike të Dardanisë (LDD) të Nexhat Dacit, madje edhe pa konsultim paraprak me këto dy parti.

Pas këtij ngërçi politik, me 15 tetor 2010, presidenti në detyrë, Jakup Krasniqi, shpalli edhe zgjedhjet e hershme parlamentare për datën 13 shkurt 2011,¹² në pajtim me shumicën e subjekteve politike në vend. Kësisoj, ky afat i ofronte kohë të mjaftueshme partive politike, por edhe KQZ-së, për të bërë përgatitjet e duhura.

Hapat që u ndërmorën nga të dy partitë pas tërheqjes së LDK-së nga koalicioni qeverisës, vazhduan të dëmtonin demokracinë e re të Kosovës si dhe procesin e shtet-ndërtimit. LDK-ja përdori strategjinë për PTK-në si shkas për tërheqje nga koalicioni, kurse PDK-ja nxitoi të nxiste zgjedhje të jashtëzakonshme, në mënyrë që të përfitonte nga kriza e krijuar. Me një datë të zgjedhjeve të caktuar për 13 shkurt 2011 dhe me një kryetar i cili u desht të jepte dorëheqje nga posti i shefit të shtetit, LDK-ja donte të luante rol opozitar ndaj PDK-së për katër muajt e mbetur. Kështu, kjo parti tentoi të distancohej nga defektet e mëdha në qeverisje me partnerin e vet PDK-në, në periudhën 2008-2010. Largimi i ministrave të LDK-së nuk ishte vetëm një shkelje e marrëveshjes së koalicionit por edhe një shkelje e praktikave qeveritare meqë ministrat e lanë punën menjëherë, pa prituri të bënin një pranim-dorëzim me zëvendësimet e tyre eventuale.

Për më tepër, LDK-ja si pjesë përbërëse e koalicionit qeverisës ishte bashkëhartuese e strategjisë për privatizim të PTK-së. Kësisoj, të gjitha vërejtjet që mund t'i ketë patur si

¹² “Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen më 13 shkurt 2011”, Zyra e Presidentit të Kosovës, 15 tetor 2010, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1401>

subjekt politik për këtë strategji, ka mundur t'i kanalizonte gjatë diskutimeve të grupeve punuese qeveritare. Si përfundim, strategjia për privatizimin e PTK-së, ka qenë më shumë shkas se sa shkak në prishjen e koalicionit qeverisës.

Hartimi i strategjisë për privatizim të PTK-së si dhe projekti tjetër madhor, ai i ndërtimit të autostradës Morinë-Merdare, kanë qenë dy projektet më së shumti të kritikuar nga shoqëria civile dhe opozita për mos-transparencë. Qeveria e Kosovës i ka mbajtur këto dy projekte shumë të mbyllura dhe larg syve të publikut dhe shoqërisë civile. Kritikant e vazhdueshme për mungesë transparence, të ngritura edhe në Kuvendin e Kosovës, kanë hasur në veshë të shurdhër të partive në pushtet.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT) janë vlerësuar të jenë ndër institucionet publike më të mbyllura dhe më jo-transparente.¹³ Kontrata e MTPT-së me kompaninë e përzgjedhur për të kryer punët në autostradën Morinë-Merdare nuk është bërë publike dhe nuk i është dhënë publikut, gjegjësisht shoqërisë civile dhe mediave, përkundër kërkesave specifike të bëra nga këto, duke u thirrur në ligjin për qasje në dokumente zyrtare. Procesi është vlerësuar si ndër proceset më jo-transparente, sidomos për faktin që qeveria nuk ka iniciuar kurrfarë debati, publik apo të mbyllur, në lidhje me këto dy projekte madhore të shtetit. Edhe debatet parlamentare kanë qenë të marginalizuara dhe të pamjaftueshme.

Fakti që qeveria ka pasur mbështetjen e faktorit ndërkombëtar për këto procese ka mjaftuar që me to të vazhdohet përkundër kritikave të shprehura në opinionin publik. Kësisoj, avokimi në Kosovë është dëshmuar të jetë i pasuksesshëm nëse ai nuk përkrahet nga faktori ndërkombëtar. Me fjalë tjera, në momentin kur qeveria e ka përkrahjen e vendeve më të fuqishme të Kuintit, për qytetarët mbetet e pamundur të avokohet në të, për ndryshime eventuale të politikave apo vendimeve.

Bashkësia ndërkombëtare ka vazhduar një qasje ndërhyrëse në zhvillimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në Kosovë edhe pas pavarësimit të vendit. Kjo qasje ka ndikuar që të zbehet ndjenja e përgjegjësisë dhe elementi i llogaridhënies tek institucionet e vendit. Kur është bërë fjalë për projekte të mëdha, udhëheqësit e këtyre institucioneve më shumë u kanë dhënë llogari vendeve të Kuintit sesa zgjedhësve të tyre. Kësisoj, mungesa e një transparence dhe llogaridhënie si pasojë e varësisë nga faktori ndërkombëtar janë dy shkaqe tjera për krizën e krijuar.

B) Buxheti i Kosovës për vitin 2011

PDK-ja si parti e vetme e mbetur në pushtet ka aluduar se një mosaprovim i mundshëm i Buxhetit të Kosovës për vitin 2011 është indikator i krizës institucionale. Raporte të ndryshme të mediave proqeveritare kanë theksuar se nuk ka klimë politike në Kuvendin e Kosovës për të aprovuar këtë buxhet. Madje, në shumë adresime, edhe vet Kryeministri

¹³ Indeksi i Transparencës së Institucioneve dhe ndërmarrjeve publike në Kosovë, Lëvizja Fol, Prishtinë, korrik 2010

Thaçi e ka përmendur aprovimin e buxhetit si arsytim për të gjetur atë që ai e ka quajtur “zgjidhje kushtetuese për të dalë nga kriza institucionale”.

Sipas diskutimeve të grupeve parlamentare dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kanë ekzistuar dy opsione për zgjidhjen e problemit të buxhetit.

Sipas opsionit të parë, mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme me ç’rast shpërbëhet Kuvendi dhe buxheti nuk diskutohet deri në mbledhjen e Kuvendit të ri që del nga këto zgjedhje. Për muajt e parë të funksionimit të qeverisjes, buxheti do të mbulohej me automatizëm sipas muajve të parë të vitit të mëparshëm fiskal.¹⁴ Ky opsion, që tanimë është aktiv pas votimit për mosbesim të qeverisë dhe caktimit të datës së zgjedhjeve me 12 dhjetor 2010,¹⁵ nuk do të kishte nevojë të aplikohet në rast se do të ishte shkuar me zgjedhjet e parakohshme, të 13 shkurtit 2011. Për më shumë, në këtë rast, Kuvendi i Kosovës do të kishte të drejtën dhe obligimin për të miratuar Buxhetin e Kosovës për vitin 2011, në bazë të përgatitjeve paraprake.

Asnjë grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës nuk ka qenë në parim kundër aprovimit të buxhetit.¹⁶ Kjo për arsye se sipas kalendarit buxhetor, dëgjimet buxhetore ishin kryer mes datës 23 gusht dhe 3 shtator, 2010, kurse ankesat nga organizatat buxhetore ishin adresuar prej 24 deri më 28 shtator. Të gjitha argumentet buxhetore ishin në favor të zgjedhjeve të parakohshme, pra, që buxheti të miratohej dhe të procedohej me qeverisje deri më 13 shkurt 2011. Kësisoj, nuk do të kishte as diskriminim ndaj komunave, të cilat kanë zhvilluar proceset autonome dhe të rregullta të konsultimeve dhe propozimeve të buxheteve të tyre në Kuvendet Komunale të cilat nuk do të merren parasysh deri pas konsolidimit të Kuvendit të ri. Një argument tjetër buxhetor që shkonte në favor të zgjedhjeve të 13 shkurtit 2011, e jo të këtyre të caktuara për 12 dhjetor 2010, qëndron tek të metat e mbulesës me automatizëm, me ç’rast për çdo muaj ndahet 1/12 pjesë e buxhetit të vitit paraprak, duke përfshirë edhe shumat e planifikuara për projekte kapitale. Këto projekte mund të jenë financuar dhe përfunduar, apo nevojat për to mund të jenë plotësisht ndryshe nga ato të vitit paraprak.

I vetmi argument në favor të zgjedhjeve të jashtëzakonshme sa i përket buxhetit ka qenë mosfunksionimi i qeverisë, marrë parasysh faktin e gjashtë (6) ministrive të LDK-së që mbetën pa ministra. Por edhe nëse Kryeministri nuk do të plotësonte këto poste ministrore, përkundër faktit që kishte mandatin për të bërë një gjë të tillë, ky argument është i zbehtë meqë ministrinë kishin kaluar të gjithë hapat e procesit të paraparë në qarkoren buxhetore të cilën, sipas ligjit në fuqi, e lëshon Ministria e Ekonomisë dhe Financave deri më 30 prill të vitit aktual fiskal.¹⁷ Çështjet buxhetore jo që ishin pengesë

¹⁴ Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 24

¹⁵ Shpërbëhet Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 3 nëntor 2010, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,3502>

¹⁶ Biseda joformale të KIPRED-it me deputetë të Kuvendit të Kosovës, tetor 2010

¹⁷ Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 20, pika 3

për pritjen e zgjedhjeve të caktuara për datën 13 shkurt, por ishin një argument në favor të këtyre zgjedhjeve dhe argument kundër zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Përfundimisht, buxheti i vitit 2011 u përdor si shkas për krizën institucionale, ndërsa ishte një shkak që do duhej të mjaftonte që vendi të mos shkonte në zgjedhje të jashtëzakonshme, por që zgjedhjet të mbaheshin siç ishte planifikuar me 13 shkurt 2011.

4. Përfundime

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe dorëheqja e Presidentit Sejdiu, përkundër faktit që i janë servuar opinionit publik si shkaqe të krizës së shkaktuar institucionale, në fakt kanë qenë vetëm shkaqe për këtë krizë. Këto akte kanë shërbyer si shkas që LDK-ja të tërhiqet në mënyrë të prerë nga qeveria, duke tentuar t'i shmanget përgjegjësisë politike për keqqeverisje dhe madje duke mos respektuar as procedurat e pritjes për dorëzim të detyrave të ministrave.

LDK-ja ka përdorur strategjinë për privatizim të PTK-së si shkas për largim nga koalicioni qeverisës, përkundër faktit që kjo parti ka qenë pjesë qenësore në hartimin e kësaj strategjie. Kësisoj, strategjia për privatizim nuk ka shkaktuar krizën institucionale ka qenë vetëm një shkas i përdorur për shmangie të obligimeve politike.

PDK-ja ka përdorur buxhetin e Kosovës për vitin 2011 si shkas për të konstatuar krizë të thellë institucionale dhe për të votuar mocionin e AKR-së për zgjedhje të jashtëzakonshme. Megjithatë, një analizë e çështjeve buxhetore tregon qartë se buxheti ishte vetëm si shkas për zgjedhje të jashtëzakonshme. Kësisoj, buxheti nuk do të miratohet deri sa të konsolidohet Kuvendi i ardhshëm, gjë për të cilën nuk ka pasur nevojë të pritët meqë përgatitjet buxhetore janë zhvilluar shumë më herët dhe të gjitha partitë politike në Kuvend kanë qenë të disponimit për të votuar buxhetin.

Përfundimisht, shkaqe qenësore të cilat kanë shkaktuar krizën ishin në fakt mosrespektimet e vazhdueshme të Kushtetutës pikë së pari nga ana e dy partnerëve të koalicionit qeverisës, PDK dhe LDK, duke vazhduar kështu një praktikë të trashëguar nga koha e UNMIK-ut ku pazaret politike kanë qenë mbi të gjitha normat juridike. Në fakt, marrëveshja e koalicionit PDK-LDK ka qenë bërë për një qëllim të caktuar – shpalljen e pavarësisë – dhe pas 17 shkurtit 2008 në një mënyrë ka qenë dashur të skadojë. Kjo pasi që pas miratimit dhe implementimit të Pakos së Ahtisaarit dhe konsolidimit të institucioneve, që ka qenë detyrë primare e koalicionit, ishte zbehur edhe interesimi i bashkësisë ndërkombëtare për ta ruajtur këtë koalicion.

Kjo është vërejtur edhe në aferën e Zanzi-Barit, që ishte një kulm i mosbesimit të krijuar si pasojë e një puçi të pasuksesshëm të iniciuar nga PDK-ja për të bërë ndryshime rrënjësore në koalicionin qeverisës, ndryshime këto që do të kishin një domino-efekt edhe në institucionet kyçe të shtetit.

Kjo marrëveshje e cila në vete ka përmbajtur ndarjen e posteve udhëheqëse por jo edhe ndonjë program qeveritar ka qenë shkaktare e ngulfatjes së jetës parlamentare në vend,

duke e dëmtuar demokracinë parlamentare. Me këtë dëmtim, në të cilin ka ndikuar edhe mungesa e demokracisë së brendshme të të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, është kontribuar në mbajtjen gjallë të koalicionit përmes infuzioneve që i kanë dhënë liderët e PDK-së dhe LDK-së dhe marrëveshjet e tyre personale. Rrjedhimisht Kuvendi i Kosovës ka shërbyer vetëm sa për t'i aprovuar vendimet e qeverisë, legjitimiteti i të cilave është vënë në pikëpyetje. Ky mosrespektim i rendit demokratik dhe shtetëror, që është një ndër vërejtjet kryesore dhe të përsëritshme të Raportit të Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian për vitin 2010, është në fakt edhe shkaku kryesor i krizës institucionale.